



Pensionimi i parakohshëm për shkaqe shëndetësore - Rasti i mësimdhënësve

Pensionimi i parakohshëm për shkaqe shëndetësore - Rasti i mësimdhënësve

Hartimit të këtij studimi i kontribuan:

Agron Demi, Ema Rraci, Kushtrim Bajrami

Nëntor 2018

Prishtinë

Publikuar nga Projekti “Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim – KEEN”

Për më shumë informata: www.keen-ks.net

Design: **envinion**:



Ky studim është përgatitur me përkrahjen e projektit “Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim - KEEN”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Ky projekt zbatohet nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), në bashkëpunim me Agjencinë për Promovimin e Punësimit në Kosovë (APPK), Balkan Sunflowers Kosovo (BSFK), Akademinë për Trajnim dhe Asistencë Teknike (ATTA) dhe Stichting SPARK. Përmbajtja e këtij publikimi nuk do të konsiderohet në asnjë mënyrë si pasqyrim i qëndrimeve të Bashkimit Evropian.

Përmbajtja

LISTA E SHKURTESAVE	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
1. HYRJE	7
2. KONTEKSTI DEMOGRAFIK DHE TREGU I PUNËS	8
3. DEMOGRAFIA E TË PUNËSUARVE NË KOSOVË	11
4. TË PUNËSUARIT NË SEKTORIN E ARSIMIT	14
5. BAZA LIGJORE PËR PENSIONET NË KOSOVË.....	21
6. PENSIONIMI I PARAKOHSHËM.....	25
6.1. Pensionet e parakohshme për punëtorët e Trepçës.....	25
6.2. Pensionet për pjesëtarët e TMK-së.....	25
6.3. Pensionet e pjesëtarëve të FSK-së	26
6.4. Pensioni i parakohshëm për shërbyesit civil	26
6.5. Pensionet e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës	26
7. PRAKTIKAT E PENSIONIMIT TË PARAKOHSHËM NË VENDET TJERA	27
8. MUNDËSITË PËR PENSIONIMIN E PARAKOHSHËM TË MËSIMDHËNËSVE NË KOSOVË	30
9. PËRFUNDIM	34
ANEKS: Të dhëna mbi nivelin e përgatitjes shkollore të mësimitdhënësve sipas grupmoshave dhe kategorive të mësimitdhënësve	35

Lista e shkurtesave

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
GDP	Gross Domestic Product (Bruto Produkti Vendor)
KEC	Qendra për Arsim e Kosovës
KEEN	Projekti “Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim”
MAP	Ministria e Administratës Publike
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MCC	Millennium Challenge Corporation Kosovo
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
SBASHK	Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Kosovës
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
Trusti	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës

Përmbledhje ekzekutive

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Kosovës (SBASHK) ka kërkuar aprovimin e ligjit për pensionimin e parakohshëm të punonjësve të arsimit, duke ndjekur shembullin e pensionimit të zyrtarëve policorë. Në rast të pamundësive buxhetore, SBASHK ka insistuar që së paku të lejohet pensionimi i parakohshëm për punonjësit e arsimit të cilët përballen me sëmundje të rënda kronike. Në anën tjetër, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) është e vetëdijshme për këtë problem dhe së fundmi ka deklaruar se është duke shqyrtuar mundësitë e aprovimit të një akti ligjor i cili do të mundësonte pensionimin e parakohshëm të këtyre personave.

Aktualisht, me ligjet në fuqi, punonjësit (mësimdhënësit) e arsimit të cilët përballen me sëmundje të rënda shëndetësore, nuk iu lejohet pushimi mjekësor më gjatë se katër (4) muaj. Për më shumë, në mungesë të zbatimit të Ligjit për sigurime shëndetësore, shpenzimet për shërim mbulohen nga vetë personi, duke e rënduar edhe më tej gjendjen financiare të tyre dhe të familjes së tyre. Për shkak të pagave të ulëta, kohës së shkurtë të kursimeve dhe modelit pensional që zbaton Kosova, qasja në kursimet pensionale në Trust nuk është zgjidhje e përshtatshme, përkundër se ekzistojnë mundësi ligjore për një gjë të tillë. Mesatarisht, një punonjës i arsimit, i cili ka kontribuar në Trust vazhdimisht që nga viti 2003, ka kursime për vetëm 15 muaj, me pension mujor prej 200 eurosh. Pas kësaj periudhe, edhe pensionerët e arsimit varen nga buxheti social i pleqërisë që e ndanë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS).

Kosova nuk duhet të aprovojë ligj i cili lejon pensionimin e parakohshëm të punonjësve të arsimit para moshës 65 vjeçare, sepse kjo do të ndikonte negativisht në ekonomi, por edhe në arsim. Nuk ka studime që dëshmojnë se gjeneratat e reja të mësimdhënësve janë më të përgatitur profesionalisht se sa gjeneratat më të vjetra. Megjithatë, institucionet duhet të shqyrtojnë mënyrat për trajtimin e rasteve të punonjësve të arsimit që vuajnë nga sëmundje të rënda kronike.

Me qëllim të zgjidhjes së këtij problemi, MASHT dhe MPMS duhet të ndër marrin një nismë të përbashkët ligjore, qoftë duke aprovuar një ligj të ri për pensionimin e parakohshëm për shkaqe shëndetësore, apo duke ndryshuar dhe plotësuar Ligjin aktual për skemat pensionale të financuara nga shteti.

Nuk ekzistojnë të dhëna të sakta për numrin e punëtorëve të arsimit të cilët vuajnë nga sëmundje të rënda kronike. Identifikimi i këtyre rasteve duhet të bëhet nga MASHT në bashkëpunim me drejtoritë komunale të arsimit. Megjithatë, duke u bazuar në moshën e punonjësve të arsimit dhe viteve të përvojës së punës, mund të llogaritet impakti buxhetor i pensionimit të parakohshëm të punonjësve të arsimit për shkaqe shëndetësore. Nëse e drejta e pensionimit të parakohshëm për shkaqe shëndetësore u njihet vetëm atyre të cilët janë mbi moshën 55 vjeçare dhe kanë së paku 20 vjet përvojë pune, dhe nëse vlerësojmë se probabiliteti i sëmundjeve të rënda kronike është 1% e punonjësve që bien në këtë kategori, kostoja vjetore e pensionit të parakohshëm për shkaqe shëndetësore

mund të ndryshojë nga mbi 156 mijë Euro (me 50% të pagës mesatare) deri në mbi 219 mijë Euro (me 70% të pagës mesatare).

Në rast se nuk aplikohet kriteri i përvojës së punës dhe moshës së mësimit dhe marrim për bazë se sërish 1% e të gjithë të punësuarve në arsim përballen me sëmundje të rënda, buxheti vjetor për pensionet e kësaj kategorie mund të ndryshojë nga mbi 651 mijë Euro (me 50% të pagës bazë në arsim - 466 Euro) deri në 912 mijë euro (me 70% të pagës bazë - 466 Euro).

Në këtë drejtim, para se të aprovohet një akt i ri ligjorë, MASHT dhe MPMS, me mbështetjen e Ministrisë së Financave, duhet të identifikojnë të gjitha rastet e punonjësve të arsimit të cilët përballen me sëmundje të rënda kronike, të vlerësojnë ndikimin financiar të kësaj skeme të re pensionale dhe të sigurojnë një komision profesional në kuadër të MPMS-së, i cili do të shmangte rastet e keqpërdorimeve gjatë procesit të verifikimit shëndetësor.

1 Hyrje

Kohëve të fundit gjithnjë e më shumë janë raportuar raste të mësimdhënësve me probleme shëndetësore të cilët janë të detyruar të paraqiten në punë, përkundër gjendjes së rënduar të tyre si pasojë e sëmundjeve të rënda kronike. Përveç si sfidë personale dhe familjare për të prekurit nga sëmundjet, raste si këto po paraqesin problem edhe për shkollat, drejtoritë e arsimit në komuna dhe nxënësit. Në anën tjetër, për shkak të kufizimeve ligjore, shkollat dhe drejtoritë e arsimit nëpër komuna, nuk mund të lejojnë shfrytëzimin e pushimit mjekësor përtej asaj që e lejon Ligji i punës. Sipas dispozitave të Ligjit të punës, punonjësi ka të drejtë të shfrytëzojë deri në 20 ditë pushim brenda një viti dhe të kompensohet me pagë të plotë, kurse në raste të sëmundjeve më të rënda ka të drejtë të shfrytëzojë edhe tre (3) muaj pushim me pagesë prej 70% të pagës nga punëdhënësi.

Megjithatë, në rastet kur sëmundja zgjat më shumë se katër muaj, punonjësve ju mbeten tri mundësi zgjedhjeje, secili i papërshtatshëm financiarisht: (1) të vazhdoj të dal në punë përkundër sëmundjes së rëndë; (2) të heqë dorë nga vendi i punës dhe të humbas të hyrat financiare; dhe (3) të aplikoj për pension të invaliditetit dhe të marr 75 euro në muaj në rast se komisioni mjekësor i MPMS vlerëson se personi nuk ka aftësi për punë.


Në anën tjetër, me politikat e deritanishme sociale, institucionet publike në vazhdimësi po i ngushtojnë mundësitë financiare për të trajtuar raste si këto. Skemat sociale bazuar në kategori, siç janë ato të veteranëve të luftës apo edhe pensionet e punonjësve të arsimit të viteve '90, kufizojnë mundësitë buxhetore për aplikimin e pensioneve të parakohshme për shkaqe shëndetësore, qoftë për të gjithë punonjësit në sektorin publik, apo vetëm për punonjësit në sektorin e arsimit.

Ky studim ka për qëllim të shqyrtoj alternativat e ndryshme për zgjidhjen e këtij problemi. Në pjesën e parë të studimit janë paraqitur të dhëna për gjendjen socio-ekonomike të qytetarëve të Kosovës për shkak se demografia e popullsisë, niveli i papunësisë, niveli i pagave, niveli i informalitetit kanë ndikim të madh në skemat pensionale. Studimi ofron një pasqyrë për moshën e të punësuarve në Kosovë, me theks të veçantë të punësuarve në sektorin e arsimit. Për më shumë, në këtë studim është shqyrtuar edhe baza ligjore për rregullimin e pensioneve, sidomos për rastet e pensionimit të parakohshëm. Me qëllim të shqyrtimit të alternativave, studimi ofron praktika të rregullimit të pensionimit të parakohshëm në disa nga vendet e Bashkimit Evropian. Në fund, studimi ofron alternativa të ndryshme se si mund të rregullohet pensionimi i parakohshëm për punonjësit e arsimit, ndikimin buxhetor që mund të kenë këto mundësi dhe rekomandimet për përgatitjen e bazës ligjore e cila mundëson pensionimin e parakohshëm të punonjësve të arsimit të cilët përballen me sëmundje të rënda kronike.

2 Konteksti demografik dhe tregu i punës

Kosova ka popullsinë më të re në Evropë, por njëkohësisht edhe papunësinë më të lartë. Nga numri i përgjithshëm i popullsisë prej 1.7 milionë banorëve në fund të vitit 2017, 43% janë nën moshën 25 vjeçare. Vetëm 8% e popullsisë është mbi moshën 65 vjeçare dhe kjo është shifra më e ulët në krahasim me të gjitha vendet tjera të Evropës. Mesatarja në vendet e Bashkimit Evropian është 19.77%.¹


Figura 1:
Përqindja e popullsisë e moshës 65+ në Evropë
(llogaritje e bazuar në të dhënat e Bankës Botërore)



¹ World Bank. Population ages 65 and above (% of population). Source: <https://bit.ly/2qIQOov>

Në bazë të parashikimit të popullsisë, si pasojë e rënies së natalitetit dhe rritjes së emigracionit përbërja e popullsisë mbi moshën 65 vjeçare do të shkojë duke u rritur dukshëm.² Në vitin 2061, Kosova do të ketë 27% të popullsisë mbi moshën 65 vjeçare. Popullsia e moshës nën 14 vjeç do të përgjysmohet, ndërsa popullsia e moshës mbi 65 vjeç do të dyfishohet. Sipas Bankës Botërore, numri i personave në moshë të punës që mbështesin një pensionist do të bie nga 10 sa është sot, në vetëm 4 më 2050.³

Figura 2:
Trendet e popullsisë së Kosovës sipas grupmoshave
(llogaritje e bazuar në të dhënat e ASK)



2 Agjencia e Statistikave të Kosovës. Parashikimi i popullsisë së Kosovës 2017-2061. Burimi: <https://bit.ly/2rKB3MW>

3 World Bank. Republic of Kosovo – Systematic Country Diagnostic. January 2017.

Sipas të dhënave të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) për tregun e punës në 2018, nga përafërsisht 1.2 milionë qytetarë në moshë pune (67% e popullsisë) vetëm 40% e tyre janë aktiv në tregun e punës.⁴ Në vitin 2017, shkalla e papunësisë ishte 30.5%⁵, përafërsisht në nivele të njëjta që nga viti 2012. Sipas ASK-së, 23.1% e vendeve të punës janë të paqëndrueshme.

Në fund të vitit 2017 ishin 352,849 kontributpagues aktiv në Fondin e Kursimeve Pensionale (Trust), një rritje prej rreth 40 mijë kontributpaguesve në krahasim me vitin 2016.⁶ Kjo rritje e kontributpaguesve i atribuohet organizimit të dy palë zgjedhjeve (lokale dhe qendrore, përfshirë edhe balotazhin), me ç'rast një numër i konsiderueshëm i qytetarëve janë angazhuar për periudhë të caktuar në menaxhimin dhe monitorimin e zgjedhjeve.

Norma mesatare e kontributeve mujore të punonjësve në Trust është 39.97 Euro, një rënie në krahasim me vitin 2016 (44.42 Euro) dhe vitin 2015 (42.21 Euro).⁷ Bilanci mesatar i të gjitha llogarive në Fondin e Kursimeve Pensionale (aktive dhe jo aktive) është 3,003 Euro. Sipas rregulloreve në fuqi për tërheqjen e pensione (200 Euro në muaj) ky bilanc mesatar është i mjaftueshëm për vetëm 15 muaj pas daljes në pension. Një përqindje mjaft e lartë e kontribuesve nismëtarë janë mbi moshën 40 vjeçare. Në 2017, nga 46,099 kontribues nismëtarë, 19.9% ishin mbi moshën 40 vjeçare.

Paga mesatare bruto në fund të 2017 ishte 528 Euro (471 Euro neto).⁸ Në sektorin publik paga mesatare është më e lartë (532 Euro bruto) se në sektorin privat (384 Euro bruto). Nga viti 2012, pagat në sektorin publik janë rritur për 30.7% (apo për 125 Euro), kurse pagat në sektorin privat janë rritur për 4.6%, apo për 17 Euro në gjashtë vitet e fundit. Rritja e pagave në sektorin privat në gjashtë vitet e fundit nuk e mbulon as inflacionin për të njëjtën periudhë. Shkalla kumulative e inflacionit sipas Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit për periudhën 2012-2017 është 6%.⁹

Të gjithë këta tregues, si shkalla e lartë e papunësisë, punësimi i vonshëm në moshë dhe kontributet e ulëta pensionale, pagat e vogla dhe trendi i rënies dhe plakjes së popullsisë, dëshmojnë për një gjendje jo të mirë socio-ekonomike në Kosovë, e cila ka ndikim të madh negativ në skemat pensionale. Edhe ata që janë në marrëdhënie pune dhe kontribuojnë në shtyllën e dytë të pensioneve (Trust), mesatarisht pas 15 muajsh nga arritja e moshës së pensionimit mbesin pa kursime dhe varen vetëm nga pensioni social (shtylla e parë pensionale). Kjo do të rëndoj edhe më tepër buxhetin e shtetit.

4 ASK. Anketa e Fuqisë Punëtore – Tremujori i dytë 2018. Burimi: <https://bit.ly/2P2wfb2>

5 ASK. Anketa e Fuqisë Punëtore 2017. Burimi: <https://bit.ly/2SDZ4BW>

6 Trust-i. Raporti vjetor 2017. Burimi: <https://bit.ly/2PzEaVW>

7 Po aty.


8 ASK. Niveli i pagave në Kosovë 2012-2017. Burimi: <https://bit.ly/2Qkg4fa>

9 ASK. Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit 2002-2017. Burimi: <https://bit.ly/2OsyU1W>

3 Demografia e të punësuarve në Kosovë

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në Kosovë janë të punësuar 357,095 persona,¹⁰ ndërsa sipas Trust-it, më 2017 ishin 352,849 kontribues aktiv, apo 26.9% e popullsisë në moshë pune.¹¹ Moshë mesatare e kontribuesve aktiv është 40.5 vjeç, kurse medianja është 39 vjet.

Figura 3:
Kontribues aktiv në Trust (2017) sipas grupmoshave
(Ilogaritje e bazuar në të dhënat e Trust-it)




Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, 131,900 prej tyre janë të punësuar në organizata buxhetore (shërbim publik dhe ndërmarrje publike), kurse 220,949 në sektorin privat (shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, shoqëri aksionare, ortakëri, organizata jo qeveritare, etj.).

¹⁰ ASK. Anketa e Fuqisë Punëtore 2017. Burimi: <https://bit.ly/2SDZ4BW>

¹¹ Trust-i. Raporti vjetor 2017. Burimi: <https://bit.ly/2PzEaVW>

Figura 4:
Të punësuarit në sektorin publik dhe privat




Nuk ka një raport gjithëpërfshirës sa i përket moshës mesatare të të punësuarve në sektorin publik. Madje as raportet vjetore të Ministrisë së Administratës Publike (MAP) për gjendjen në shërbimin civil nuk përmbajnë të dhëna për moshën e shërbyesve civil.¹²

Sipas anketës së Millennium Foundation Kosova (MCC) për tregun e punës del se të rinjtë e moshës 15 deri 35 në masë të madhe punojnë në sektorin privat, gjersa të punësuarit mbi moshën 45 vjeç kanë tendencë më të madhe për të punuar në sektorin publik.¹³

¹² Ministria e Administratës Publike. Raport mbi gjendjen e shërbimit civil të Republikën e Kosovës për vitin 2017. Maj 2018.

¹³ Social Impact for Millennium Challenge Corporation. Kosovo Labor Force and Time Use Research Report. February 2018. Burimi: <https://bit.ly/2AJkd6Y>

Figura 5:
Të punësuarit sipas sektorëve dhe grupmoshave
(Ilogaritje e bazuar në të dhënat e MCC)




Sipas një raporti të Institutit GAP, çdo vit rreth 1.9% e shërbyesve publik (1,436 punonjës) arrijnë moshën e pensionimit, kurse 9.7% e shërbyesve publik (7,179 punonjës) janë mbi moshën 60 vjeçare.¹⁴

¹⁴ Instituti GAP. Madhësia e Administratës Publike – propozim për uljen e numrit të të punësuarve në administratën publike. Korrik 2015, Prishtinë. Burimi: <https://bit.ly/2zpHtF5>

4 Të punësuarit në sektorin e arsimit

Në të gjitha nivelet e arsimit para-universitar në Kosovë janë të punësuar 28,121 persona, prej tyre 23,281 mësimdhënës, 3,181 personel ndihmës dhe 1,659 personel administrativ.¹⁵ Ndërsa në nivelin universitar, në shtatë universitetet publike, janë të angazhuar 2,330 punonjës.

Figura 6:
Të punësuarit në arsim sipas gjinisë dhe kategorive



Burimi: Statistikat e arsimit në Kosovë 2017/2018

Mosha mesatare e të punësuarve në arsimin parauniversitar është 45 vjeç, aq sa është edhe mediania e moshës së të gjithë të punësuarve. Mosha mesatare e punonjësve të arsimit është për dhjetë (10) vite më e lartë se sa mosha mesatare e popullsisë së Kosovës, e cila vlerësohet të jetë 30.2 vite.¹⁶

Nga numri i përgjithshëm i mësimdhënësve, 75% janë të angazhuar në nivelin parafillor, fillor dhe të mesëm të ulët, ndërsa 23% në nivelin e mesëm të lartë.

¹⁵ MASHT dhe ASK. Statistikat e arsimit në Kosovë 2017-2018. Burimi: <https://bit.ly/2DjfNWE>


¹⁶ ASK. Vjetari statistikor i Republikës së Kosovës 2018. Burimi: <https://bit.ly/2QedNSI>

Figura 7:
Mësimdhënësit sipas kategorive
(Ilogaritje e bazuar në të dhënat e MAP)




Nëse shikojmë shpërndarjen e mësimdhënësve sipas moshës dhe gjinisë, në figurën 8 shihet se mësimdhënësit nën moshën 55 vjeçare janë më shumë gra, përderisa mësimdhënësit mbi moshën 55 vjeçare janë më shumë burra.

Figura 8:
Mësimdhënësit sipas moshës dhe gjinisë (Ilogaritje e bazuar në të dhënat e MAP)



Mesatarja e viteve të përvojës së punës (jo vetëm në arsim) e të gjithë mësimdhënësve është 16 vite.¹⁷ Nga numri i përgjithshëm i mësimdhënësve, 40% kanë më pak se 11 vjet përvojë pune.


Figura 9:
Mësimdhënësit sipas përvojës së punës
(Ilogaritje e bazuar në të dhënat e MAP)



¹⁷ Databaza e të gjithë të punësuarve në arsimin parauniversitar, të dhëna të siguruara nga MAP me kërkesë të Projektit KEEN, tetor 2018.


Në dhjetë vitet e ardhshme, mesatarisht çdo vit do të dalin në pension 640 mësime.

Figura 10:
Mësime sipas moshës
(Ilogaritje e bazuar në të dhënat e MAP)




Nëse e shikojmë nga niveli i përgatitjes shkollore, pjesa më e madhe e mësimitdhënësve janë me fakultet (79%).

Figura 11:
Mësimitdhënësit sipas nivelit të shkollimit
(Ilogaritje e bazuar në të dhënat e MAP)




Nëse e shikojmë për nga mosha dhe përgatitja shkollore, shihet se ata që kanë të kryer shkollën normale janë kryesisht mësimitdhënësit mbi moshën 60 vjeçare, me shkollim të lartë pedagogjik (SHLP) janë kryesisht mësimitdhënësit e moshës 57 vjeçare e sipër, mësimitdhënësit mes moshës 25 dhe 55 vjeçare janë kryesisht me nivelin bachelor, kurse ata me magistraturë dhe doktoratë janë të shtrirë në të gjitha grupmoshat, por me një nivel pak më të lartë tek mësimitdhënësit në të 30-tat.

Figura 12:
Niveli i shkollimit të mësimit sipas moshës (Ilogaritje e bazuar në të dhënat e MAP)



Përderisa paga mesatare e të gjithë mësimsdhënësve është 413 Euro, paga bazë, paga bruto dhe shtesat në paga rriten sipas moshës së mësimsdhënësve. Mësimsdhënësit më të moshuar paguhen më shumë se sa mësimsdhënësit më të rinj në moshë.

Figura 13:
Pagat dhe shtesat e mësimsdhënësve sipas moshës (llogaritje e bazuar në të dhënat e MAP)



Nëse e shikojmë pagën bruto sipas grupmoshave, mesatarja e pagës bruto për mësimsdhënësit mbi moshën 55 vjeçare është 532 Euro, kurse për mësimsdhënësit mes moshës 25 dhe 35 vjeçare paga mesatare bruto është 452 Euro.

5 Baza ligjore për pensionet në Kosovë

Ligji bazik i cili rregullon marrëdhënien e punës në Kosovë është Ligji i punës¹⁸. Në Ligjin e punës nuk ka mjaft dispozita që e rregullojnë çështjen e pensionimit. Në këtë ligj, pensionimi përmendet vetëm në kushtet për ndërprerjen e kontratës, ku një nga arsyet e ndërprerjes së kontratës së punës është edhe arritja e moshës së pensionimit, e cila është 65 vjet.¹⁹ Sipas Ligjit të punës, pensioni i moshës dhe ai i parakohshëm duhet të rregullohen me ligj të veçantë.²⁰

Në vitin 2014, ka hyrë në fuqi Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti²¹, i cili unifikon në një ligj të vetëm disa skema pensionale përfshirë, pensionin bazik të moshës, skemën e pensionit kontributpagues të moshës, skemën e pensionit të aftësisë së kufizuar, skemën e pensionit të parakohshëm, pensionin familjar dhe pensionin invalidor të punës. Ndërkaq, të papërfshira në këtë ligj mbeten skemat pensionale për ish pjesëtarët e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK), pensionet për pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), pensionet e veteranëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) etj.

18 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.03/L-212 i punës. Ka hyrë në fuqi në nëntor 2010. Burimi: <https://bit.ly/2ix6Pc3>

19 Neni 67 i Ligjit të punës.

20 Neni 11 i Ligjit të punës.

21 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.04/L-131 për skemat e financuara nga shteti. Maj 2014. Burimi: <https://bit.ly/2NxOC1r>

Tabela 1:

Skemat pensionale të financuara nga shteti, numri i përfituesve dhe buxheti vjetor (Llogaritje e bazuar në të dhënat e ASK, Statistikat e Mirëqenies Sociale 2017 dhe Raportit të Buxhetit 2017)

Lloji i pensionit	Përshkrimi	Nr. i përfituesve 2017	Buxheti 2017 (€)
Pensioni bazik i moshës	Pensioni minimal i rregullt mujor i paguar për të gjithë qytetarët e Kosovës, që kanë arritur moshën 65 vjeçare, pa marrë parasysh, a kanë qenë të punësuar apo jo.	122,716	113,079,075
Pension kontributpagues i moshës	Pensioni i rregullt mujor për qytetarët e punësuar të Kosovës, të cilët i kanë paguar kontributet, në ish-Fondin Pensional të Kosovës para datës 1 janar 1999.	43,300	90,672.452
Pensioni i paaftësisë të përhershme	Pensioni i rregullt mujor i paguar për ata të cilët nuk mund të hyjnë në marrëdhënie pune për shkak të paaftësive fizike, pas një vlerësimi profesional nga një Komision Mjekësor.	19,481	18,878,980
Pension i para-kohshëm	Pensioni i rregullt mujor i paguar për minatorët e kompleksit “Trepça”, dhe minatorëve të tjerë të punësuar në minierat e tjera të Kosovës.	3,232	4,198,000
Pensionet e TMK	Pension për ish pjesëtarët aktiv të TMK-së që kanë shërbyer së paku pesë vite dhe që nuk janë transferuar në FSK, e të cilët mund të marrin pension që nga mosha 45 vjeçare.	1,001	2,684,000

Pensionet e FSK	Pension mujor që i paguhet pjesëtarit të FSK-së, i cili i plotëson kriteret e përcaktuara në Ligjin për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës.	288	1,200,000
Pensioni për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës së UÇK	Pension që i ndahet familjarëve të dëshmorëve në luftën e UÇK-së dhe pjesëtarëve të luftës të cilët kanë shkallë invaliditeti prej së paku 10%.	12,472	36,633,457
Pensioni i veteranit të UÇK	Qytetari i Kosovës dhe shtetasi i huaj i cili është radhitur në radhët e UÇK-së, dhe është regjistruar si ushtar i armatosur dhe i uniformuar nga komandat, shtabet e zonave operative të UÇK-së, përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, dhe i cili ka qenë aktiv deri në përfundimin e luftës.	36,032	65,854,654
Pensioni invalidor i punës	Pensioni i rregullt mujor, i paguar për personat që pësojnë lëndime në punë apo fitojnë sëmundje profesionale gjatë marrëdhënies së punës.	-	Ka filluar së aplikuari më 2018 dhe në nëntë muajt e parë janë shpenzuar 130 mijë euro.
Pensioni familjar	Pensioni i rregullt mujor i paguar për anëtarët e familjes në rast të vdekjes së të punësuarit, që ka qenë në marrëdhënie pune.	-	Ka filluar së aplikuari më 2018 dhe në nëntë muajt e parë janë shpenzuar 4.8 milionë euro.
Gjithsej		238,522	242,618,838

Të gjitha kategoritë e lartcekura të përfituesve të pensioneve në fakt janë pagesa sociale të ndërlidhura me moshën e qytetarëve, aftësitë fizike apo bazuar në kategori.

Përveç skemave pensionale të financuara nga shteti, me Ligjin për fondet pensionale të Kosovës²² rregullohen edhe pensionet e bazuara në kursime individuale. Administrimi i kursimeve individuale bëhet nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti). Çdo punëdhënës është i obliguar që të kontribuoj në emër të punonjësve të vet në Fondin e kursimeve pensionale.

Çdo punëdhënës paguan një shumë që është baras me pesë (5) përqind të rrogave të përgjithshme të të gjithë punonjësve, ndërsa çdo punonjës paguan një shumë që është baras me pesë (5) përqind të rrogës së tërësishme të tij/saj. Punëdhënësit mund të kontribuojnë vullnetarisht për një shumë plotësuese deri në dhjetë (10) përqind të rrogës vjetore. Po ashtu, punonjësit mund të kontribuojnë vullnetarisht një shumë plotësuese deri në dhjetë (10) përqind të rrogës së tyre vjetore, për kontributin e përgjithshëm prej pesëmbëdhjetë (15) përqind të rrogës.²³ Kursimet individuale në formë të pensioneve nga Fondi i Kursimeve Pensionale mund të tërhiqen në tri raste si në vijim: a) kur kontribuesi arrin moshën 65 vjeçare, b) në rastet kur vlerësohet se kontribuesi ka të drejtë në pension invalidor para arritjes së moshës së pensionimit, c) në rast vdekje të kontributpaguesit pensioni i paguhet përfituesve/familjarëve. Procedurat dhe rregullat për marrjen e pensionit të parakohshëm bazuar në invaliditetin e kontributpaguesve i përcakton Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Përveç pensioneve bazike dhe kontributeve pensionale të detyrueshme, qytetarët e Kosovës e kanë mundësinë edhe të kontributeve vullnetare individuale të cilat mund të bëhen nga të punësuarit mbi baza vullnetare në njërin nga fondet pensionale të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK).

22 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës. Prill 2012. Burimi: <https://bit.ly/245sNGN>. Ky ligj është ndryshuar dhe plotësuar në dhjetor 2016 me Ligjin nr.05/L-116. Burimi: <https://bit.ly/2CrTAop>

23 Neni 6 i Ligjit nr.04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës.

6 Pensionimi i parakohshëm

Ligji i punës përcakton se kriteret për pensionim të parakohshëm duhet të rregullohen me ligj të veçantë. Për më shumë, edhe drafti aktual i projektligjit të punës, i cili pritet të zëvendësoj ligjin në fuqi, nuk e rregullon pensionimin e parakohshëm duke e përcaktuar që çështja e pensionimit të parakohshëm të rregullohet me ligj të veçantë.

Kosova nuk ka një ligj gjithëpërfshirës për pensionim të parakohshëm për të punësuarit. Pensionimi i parakohshëm, deri më tani është rregulluar me ligje të veçanta për profesione të ndryshme, siç është rasti i punonjësve të Trepçës, pjesëtarëve të ish-Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK), pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Për pensionet para moshës 65 vjeçare mund të kualifikohen edhe shërbyesit civil. Nga viti 2013 pjesë e programeve legislative është edhe projektligji i cili rregullon pensionet e parakohshme të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, por i cili ende nuk është aprovuar. Kategoritë tjera të të punësuarve nuk përfshihen në skemat e pensionimit para moshës 65 vjeçare. Përjashtim bëjnë personat të cilët kanë kontribuar në Trust dhe nuk e kanë arritur moshën 65 vjeçare, por një komision mjekësor nga MPMS vlerëson se për shkak të invaliditetit ata duhet të tërheqin mjetet e kursyera. Në këto raste, personi mund të marrë 200 Euro në muaj nga Trusti, deri në përfundim të periudhës së invaliditetit apo derisa kursimet e tyre shterojnë. Në këtë formë, në 2017 kursimet i kanë tërhequr 174 persona (175 persona në 2016).²⁴

6.1. Pensionet e parakohshme për punëtorët e Trepçës

Me Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti, në kategorinë e pensioneve të parakohshme hyjnë vetëm pensionet për punonjësit e kompleksit industrial Trepça dhe minierat e tjera të Kosovës. Për pension të parakohshëm kualifikohen ata punonjës të minierave të cilët kanë humbur vendin e punës para vitit 2004, kanë 10 vite përvojë pune, kanë mbushur moshën 50 vjeçare ose kanë shkallë invaliditeti mbi 50%.²⁵ Pensionet ndahen nga buxheti i shtetit, përmes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Shuma e pensionit në 2017 ishte 105 Euro në muaj, kurse numri i përfituesve ishte 3,232.²⁶

6.2. Pensionet për pjesëtarët e TMK-së

Ish-pjesëtarët e TMK-së klasifikohen të marrin pension të parakohshëm që nga moshja 45 vjeçare nëse kanë së paku pesë (5) vite përvojë pune dhe nuk janë transferuar në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Shuma e pensionit është ekuivalente me mesataren e pagave në tri vitet e fundit të shërbimit në TMK. Në rast se pensioni merret nga moshja 45 vjeçare, niveli i pensionit është 50% e pagës, kurse nga moshja 50 vjeçare është 70% e pagës.²⁷ Pensionet ndahen nga buxheti i shtetit, përmes MPMS-së, dhe në vitin 2017 ishin 1,001 përfitues.

²⁴ Trust-i. Raporti vjetor 2017. Burimi: <https://bit.ly/2PzEaVW>

²⁵ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.04/L-131 për skemat e financuara nga shteti. Maj 2014. Burimi: <https://bit.ly/2NxOC1r>

²⁶ ASK. Statistikat e Mirëqenies Sociale 2017. Burimi: <https://bit.ly/2CX5Jlr>

²⁷ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.03/L-100 për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/2Rydl5W>

6.3. Pensionet e pjesëtarëve të FSK-së

Pjesëtari i Forcës së Sigurisë së Kosovës i cili ka 20 vite shërbim në FSK dhe ka arritur moshën 50 vjeçare, kualifikohet për pension të parakohshëm. Shuma e pensionit bazohet duke llogaritur 40% të pagës së pjesëtarit të FSK-së dhe duke shtuar 2% për çdo vit shërbimi për pjesëtarët aktiv (por që nuk mund të kalojë 60% të pagës bazë) dhe 0.5% për pjesëtarët rezervë. Pensionet paguhet nga buxheti i shtetit përmes MPMS-së dhe në vitin 2017 ishin 288 përfitues.

6.4. Pensioni i parakohshëm për shërbyesit civil

Me Ligjin për shërbimin civil parashihet pensionimi i parakohshëm për këtë kategori të punonjësve.²⁸ Shërbyesit civil që kanë mbushur moshën 63 vjeçare mund të aplikojnë për pension të parakohshëm, ose mund të iu kërkohet pensioni i parakohshëm në rastet e reduktimit të personelit.

Në rast të pensionimit të parakohshëm, shërbyesi civil ka të drejtën e pensionit prej 70% të pagës së fundit, deri sa të arrijë moshën 65 vjeçare.²⁹ Pensioni i parakohshëm për shërbyesit civil paguhet nga buxheti i institucionit ku personi ka qenë i punësuar. Në vitin 2017 nga shërbimi civil janë pensionuar para kohës 14 punonjës.³⁰

6.5. Pensionet e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës

Nga viti 2013 vazhdimisht në secilin program legjislativ të Qeverisë së Kosovës është përfshirë edhe projektligji për pensionet e zyrtarëve policor të Policisë së Kosovës dhe punonjësit e Inspektoratit Policor me autorizime policore. Në programin legjislativ për 2018 është planifikuar që ky projektligj të aprovohet nga Qeveria në fund të muajit shtator 2018, por ende nuk është aprovuar.

Sipas këtij projektligji³¹, i cili ka qenë në diskutim publik në muajin gusht 2018, zyrtarët policor do të pensionohen në moshën 55 vjeçare, me disa përjashtime në nivelin e lartë drejtues të cilët mund të punojnë edhe tri vite pas moshës 55 vjeçare; kurse pensioni i parakohshëm mund të merret që nga mosha 50 vjeçare.

Zyrtarët policorë të cilët kanë 20 vjet përvojë pune dhe pensionohen në moshën 55 vjeçare, marrin 40% - 60% të pagës së fundit, derisa të arrijnë moshën 65 vjeçare, ku pastaj marrin pensionin nga Trusti. Ndërsa, ata që marrin pension të parakohshëm nga mosha 50 deri 55 vjeç mund të marrin 35% - 50% të pagës së fundit. Nga mosha 55 deri 65 vjeçare mund të marrin deri në 70% të pagës së fundit.

Pensionet për zyrtarët policor për 10 deri 15 vite do të paguhet nga buxheti i shtetit. Për ndikimin buxhetor që do të ketë ky ligj ka reaguar edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar.³²

28 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës. Neni 92. Burimi: <https://bit.ly/1D2CvaW>

29 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Rregullore nr.13/2012 për pensionimin e parakohshëm të nëpunësve civil.

30 Ministria e Administratës Publike. Raport mbi gjendjen e shërbimit civil të Republikën e Kosovës për vitin 2017. Maj 2018.

31 Projektligji për pensionet e zyrtarëve policor të Policisë së Kosovës dhe punonjësit e Inspektoratit Policor me autorizime policore. Burimi: <https://bit.ly/2Oq9fGW>

32 IMF. IMF Country report no.16/123 – Kosovo Technical Assistance Report – enhancing social protection cash benefits. May 2016.

7 Praktikak e pensionimit të parakohshëm në vendet tjera

Vende të ndryshme zbatojnë modele të ndryshme pensionale. Shumica e vendeve si moshë standarde të pensionimit kanë moshën 65 vjeçare. Në disa vende moshja e pensionimit për gratë dhe burrat ndryshon, ku gratë dalin më herët ne pension. Megjithatë, së fundmi kjo praktikë po ndryshohet, duke harmonizuar moshën e pensionimit për gratë dhe burrat.³³ Për shkak të rritjes së jetëgjatësisë, vendet e Evropës janë në proces të rritjes së moshës së pensionimit mbi 65 vjeç. Vendime për rritjen e moshës së pensionimit janë marrë në Gjermani, Izrael, Norvegji, Holandë, Mali i Zi, etj.

Rritja e jetëgjatësisë ka pasur ndikim edhe në pensionet e parakohshme, kryesisht duke eliminuar mundësinë e pensionimit të parakohshëm apo duke ulur nivelin e pensioneve. Në të kaluarën, vende të ndryshme kanë promovuar pensionimin e parakohshëm kryesisht për dy arsye, përfshirë rritjen e punësimit të të rinjve, ose ristrukturimin e ndërmarrjeve publike. Belgjika dhe Spanja inkurajuan pensionimin e parakohshëm si masë për rritjen e punësimit të të rinjve. Vende si Kina dhe Rumania kanë inkurajuan pensionimin e parakohshëm me qëllim të reformimit të ndërmarrjeve publike, me arsyetimin se produktiviteti i punëtoreve bie me kalimin e moshës.³⁴ Shumica e vendeve të bllokut ish-Sovjetik pensionimin e parakohshëm e kanë inkurajuan si formë për përgatitjen e ndërmarrjeve shoqërore për privatizim.³⁵ Kurse në Holandë dhe Hungari, arsyeja kryesore për pensionim të parakohshëm është për shkak të paaftësisë si pasojë e sëmundjeve të moshës.³⁶

Megjithatë, sipas një studimi të Bankës Botërore, pensionimi i parakohshëm për arsye të rritjes së punësimit të të rinjve ose ngritjes së profesionalizmit në ndërmarrjet shoqërore, nuk ka treguar rezultate të kënaqshme.³⁷ Studimi vlerëson se nuk ka dëshmi se punësimi i të rinjve është rritur si rezultat i pensionimit të parakohshëm të gjeneratave më të vjetra. Po ashtu, shembujt nga Bullgaria dhe Rumania dëshmojnë se pensionimi i parakohshëm më shumë ka ndikuar në rënien e punësimit, se sa në zëvendësimin e tyre me punëtorë të rinj.

Tabela në vijim përmbledh shkurtimisht praktikak e pensionimit të parakohshëm në disa nga vendet evropiane.

33 Nga viti 2018 në Britani të Madhe gratë dhe burrat arrijnë moshën e pensionimit kur të mbushin 65 vjeç. Deri më tani moshja e pensionimit për burra ishte 65 vjeç, kurse për gratë 62.5. Nga viti 2019 pritet që moshja e pensionimit të rritet në 66 për të dy gjinitë, por ky rregull aplikohet për gjeneratat që kanë lindur më vonë. Edhe Austria ka harmonizuar moshën e pensionimit për gratë dhe burrat dhe harmonizimi i plotë pritet të ndodhë në 2033.

34 World Bank. Averting the old age crisis – policies to protect the old and promote growth. Published by Oxford University Press, 1994.

35 Po aty.

36 Po aty.

37 Po aty.

Tabela 2:
Pensionimi i parakohshëm në disa nga vendet e Evropës

Shteti	Kriteret për pensionim të parakohshëm
Bullgaria	<p>Bullgaria është një ndër vendet e pakta që lejon pensionimin e parakohshëm edhe për mësimdhënësit. Në Bullgari ekzistojnë dy skema të ndara pensionale që lejojnë pensionimin e parakohshëm:</p> <p>E para, Fondi Pensional i Mësimdhënësve, i cili bazohet në kursimet e detyruara të mësimdhënësve dhe mund të shfrytëzohet nga moshë 58.2 vjeç për gra dhe 61.1 vjeç për burra. Kontributet në Fondin Pensional të Mësimdhënësve bëhen krahas kontributeve në fondin pensional të rregullt. Kështu, mësimdhënësit kontribuojnë në dy fonde të ndara pensionale. Për të përfituar nga pensionimi i parakohshëm, mësimdhënësit duhet të kenë së paku 25.8 vjet përvojë pune (gratë), respektivisht 30.8 për burrat. Nga 1 janari 2018, ka filluar ngritja graduale e moshës së pensionimit të parakohshëm për të dy gjinitë, deri sa të arrijë në moshën 62 vjeç. Pensionet reduktohen për 0.1% për çdo muaj të tërheqjes së pensionit para moshës standarde të pensionimit.³⁸</p> <p>E dyta, pensionimi i parakohshëm nga Fondi Profesional i Pensioneve për të gjithë ata që punojnë në profesione të veçanta (miniera, ushtri, etj.), me rrezik të lartë për shëndetin. Ky pension mund të tërhiqet nga moshë 47.8 vjeç për gratë dhe 52.8 vjeç për burrat, me kusht që punëtorët kanë kontribuar për së paku 10 vite në këtë fond.³⁹</p>
Sllovenia	<p>Pensionimi i parakohshëm është e drejtë e garantuar nga moshë 59.8 vjeç për gratë dhe 60 vjeç për burrat, me kusht që aplikuesi për pension të parakohshëm të ketë së paku 40 vjet përvojë pune dhe kontribute. Shuma e pensionit reduktohet për 0.3% për çdo muaj të pensionimit të parakohshëm, ose në total 18% dhe ky reduktim është i përhershëm, që nënkupton se vlen edhe kur personi mbush moshën 65 vjeç.⁴⁰</p>
Kroacia	<p>Pensionimi i parakohshëm në Kroaci është e drejtë e secilit person i cili ka mbushur 57 vjeç dhe ka 31 vjet përvojë pune (për gratë), respektivisht 60 vjeç për burrat dhe me përvojë minimale prej 35 viteve. Pjesë e përvojës së punës mund të llogaritet edhe 2 vite papunësi, në rastet e falimentimit të ndërmarrjeve. Shuma e pensionit mund të ulet nga 0.10% deri në 0.34% për çdo muaj të pensionimit të parakohshëm. Reduktimi në pension nuk aplikohet në rastet kur aplikuesi për pension të parakohshëm ka së paku 41 vite përvojë pune dhe kontribute.⁴¹</p>

38 CESifo Group. Early retirement conditions in the EU 2014. Burimi: <https://bit.ly/2Fg6top>

39 Po aty.

40 European Commission. Your social security rights in Slovenia. 2018.

41 European Commission. Your social security rights in Croatia. 2018.

Mali i Zi

Në vitin 2010, Mali i Zi ngriti moshën e pensionimit në 67 vjet, por njëkohësisht lejoi pensionimin e parakohshëm që nga mosha 62 vjeçare, për të gjithë sektorët dhe për të gjithë punonjësit me më së paku 15 vite përvojë pune. Për profesionet e rrezikshme, si punonjësit e policisë, sigurisë dhe industrisë, pensionimi i parakohshëm mund të merret që nga mosha 50 vjeçare.⁴² Për të gjithë ata që marrin pension të parakohshëm para moshës 67 vjeçare, pensioni iu reduktohet për 0.35% në muaj, apo deri në 21% në rast se marrin pension nga mosha 62 vjeçare.

Austria

Pensionimi i parakohshëm në Austri është i mundshëm nga mosha 62 vjeçare dhe kjo vlen vetëm për burrat, për shkak se mosha e pensionimit për gratë është më e ulët se sa për burrat. Për pensionim të parakohshëm mund të aplikojnë të gjithë ata të cilët kanë së paku 40 vjet kontribute. Pensioni reduktohet për 4.2% për çdo vit të pensionimit të parakohshëm, por jo më shumë se 15% në total.⁴³

Holanda

Holanda nuk lejon pensionimin e parakohshëm. Punonjësit nën moshën 65 vjeçare të cilët përballen me sëmundje dhe nuk mund të punojnë, në dy vitet e para të paaftësisë paguhen nga punëdhënësi në vlerën e 70% të pagës. Në rast se sëmundja zgjat më shumë se dy vite, atëherë ata mbulohen nga WIA (Work and Income Act).⁴⁴

Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar në vazhdimësi kanë kundërshtuar politikat mjaft gjeneroze për pensionim të parakohshëm, duke kërkuar në vazhdimësi që të ketë kujdes me programet për pensionim të parakohshëm. Vlerësohet se pensionimi i parakohshëm ndikon në rënie të GDP-së nga 2-4% në vendet e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim (OECD).⁴⁵

42 World Bank. Options for reforming early retirement systems for special and hazardous occupations in Montenegro. June 26, 2017.

43 European Commission. Your social security rights in Austria, 2018. Burimi: <https://bit.ly/2T0iyVz>

44 European Commission. Your social security rights in Netherlands. 2018.

45 World Bank. Averting the old age crisis – policies to protect the old and promote growth. Published by Oxford University Press, 1994.

8 Mundësitë për pensionimin e parakohshëm të mësimit në Kosovë

Praktikat e pensionimit të parakohshëm në Kosovë ndërlidhen me shuarjen e vendeve të punës (TMK), rrezikshmërinë në vendin e punës (FSK) dhe vështirësitë e profesionit (Trepça). Në këtë kuptim, punonjësit e arsimit nuk përfshihen në asnjërën nga këto kategori. Përfshirja e mësimit në mësimit si kategori e veçantë e cila mund të klasifikohet për pension të parakohshëm është praktikë shumë e rrallë.⁴⁶

Punonjësit e arsimit përbëjnë 21.3% të të gjithë të punësuarve në sektorin publik dhe 8% të të gjithë kontributpaguesve në Fondin e Kursimeve Pensionale. Siç është cekur edhe më sipër, moshë mesatare e punonjësve të arsimit është 45 vite, ndërsa, mbi moshën 60 vjeçare janë 12.6% e punonjësve në arsimin parauniversitar.

SBASHK ka kërkuar hartimin e ligjit për pensionim të parakohshëm të të gjithë punonjësve të arsimit duke marrë shkas projektligjin për uljen e moshës së pensionimit të zyrtarëve policorë. SBASHK ka kërkuar që në rast të pamundësisë së aprovimit të ligjit për pensionim të parakohshëm të të gjithë punonjësve në arsimin parauniversitar, që të paktën të përgatitet një akt ligjorë i cili mundëson pensionimin e mësimit në mësimit që vuajnë nga sëmundje të rënda kronike.⁴⁷ Në anën tjetër, të dhënat për numrin e mësimit në mësimit të cilët vuajnë nga sëmundje të rënda kronike nuk i posedojnë as SBASHK-u dhe as MASHT. MASHT ka deklaruar që janë duke shqyrtuar mundësinë që përmes një akti nënligjor të rregullojnë pensionimin e parakohshëm të mësimit në mësimit që vuajnë nga sëmundje të rënda kronike.⁴⁸

Buxheti i Kosovës nuk mund të përballojë uljen e moshës së pensionimit për të gjithë mësimit në Kosovë. Pensionimi i parakohshëm i mësimit është praktikë e rrallë, e cila është duke u ndryshuar edhe në ato vende të cilat aplikohet deri më tani. Në rast të pensionimit të parakohshëm nga moshë 55 vjeçare, me 70% të pagës bazë dhe me pagën bazë mesatare në sektorin e arsimit prej 413 Euro në muaj, në dhjetë (10) vitet në vazhdim do të nevojiteshin mbi 119 milionë Euro për mbulimin e pensioneve të mësimit në mësimit, apo mbi 22 milionë Euro në vitin e parë.

46 Sipas Bankës Botërore, në vitin 1994 ekzistonin vetëm pesë vende të cilat u garantonin pensionim të parakohshëm mësuesve: Brazili, Bulgaria, Nikaragua, Polonia dhe Urugai. Burimi: World Bank. Averting the old age crisis – policies to protect the old and promote growth. Published by Oxford University Press, 1994.

47 Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës. Apel publik i SBASHK-ut drejtuar MASHT-it dhe institucioneve tjera, 22 gusht 2018. Burimi: <https://bit.ly/2T33v9u>

48 Edona Kutleshi. Pensionimi i mësimit në mësimit të sëmurë pritet të rregullohet me ligj. Koha Ditore, 24 gusht 2018. Fq.5.

Tabela 3:

Kostoja buxhetore e uljes së moshës së pensionimit për mësimdhënësit

Mosha	Nr. i mësimdhënësvë	Shuma e pensionit (70% e pagës bazë në arsim)	Nr. i pensioneve deri në moshën standarde të pensionimit (65)	Vlera (€) e pensioneve deri në moshën 65 vjeçare
55 vjeç	595	289.1€	120	20,641,740
56 vjeç	584	289.1€	108	18,234,115
57 vjeç	589	289.1€	96	16,346,870
58 vjeç	702	289.1€	84	17,047,649
59 vjeç	643	289.1€	72	13,384,174
60 vjeç	653	289.1€	60	11,326,938
61 vjeç	601	289.1€	48	8,339,957
62 vjeç	672	289.1€	36	6,993,907
63 vjeç	645	289.1€	24	4,475,268
64 vjeç	715	289.1€	12	2,480,478
Gjithsej:				119,271,096

Në rast se mosha e pensionimit për punonjësit e arsimit do të vendosej nga mosha 60 vjeç, atëherë në pese (5) vitet në vazhdim buxheti për pensione do të ishte mbi 33.5 milionë Euro, ose mbi 11 milionë Euro në vitin e parë.

Përveç nga pikëpamja buxhetore, pensionimi i parakohshëm i mësimdhënësvë për arsye të moshës nuk gjen arsytim nga pikëpamja profesionale apo e reformimit të arsimit. Nuk ka asnjë studim që argumenton se gjeneratat e reja të mësimdhënësvë janë më të përgatitura se gjeneratat më në moshë, përkundër asaj se gjeneratat e reja kanë nivele më të larta të shkollimit, por problem mbetet cilësia e këtyre studimeve.

Mësimdhënësit mbi moshën 55 vjeçare mesatarisht marrin 80 euro më shumë se sa mësimdhënësit nën moshën 35 vjeçare, dhe ky dallim në pagën bruto mund të ndikoj në zbutjen e impaktit financiar në rast të zëvendësimit të mësimdhënësvë më të moshuar me mësimdhënësit e rinj, por prapë se prapë nuk e mbulon tërë koston financiare të pensionimit të parakohshëm.

Pensionimi i parakohshëm për arsye shëndetësore nuk është i mbuluar ligjërisht në Kosovë. Aktualisht, me ligjet në fuqi, një punëtor (si në sektorin publik ashtu edhe në privat) në rast të sëmundjeve të rënda kronike të cilat

pamundësojnë vazhdimin e punës detyrohet të hyjë në skemën pensionale të invaliditetit të punës dhe të marr 75 Euro në muaj, në rast se Komisioni mjekësor i MPMS vlerëson paaftësinë për punë; ose të filloj tërheqjen e kursimeve pensionale nga Trusti, në shumën prej 200 Euro në muaj, në rast se komisioni mjekësor i MPMS jep pëlqim për këtë. Asnjëra nga këto zgjidhje nuk siguron mjete financiare të mjaftueshme për trajtimin e sëmundjeve dhe shpenzimeve tjera bazike. Duke marr parasysh kursimet e ulëta, personat që shfrytëzojnë kursimet e Trustit para arritjes së moshës 65 vjeçare mund të mbeten pa pension nga Trusti kur të arrijnë moshën standarde të pensionimit. Për shembull, një mësimitdhënës i moshës 62 vjeçare i cili përballet me sëmundje të rëndë kronike e cila e detyron t'i qaset kursimeve të Trust-it, pensioni i tij do të shteroj pak para se të mbërrij moshën 64 vjeçare.

Gjendja e kësaj kategorie vështirësohet edhe më shumë kur dihet se edhe më tej nuk ka filluar zbatimi i Ligjit për sigurimet shëndetësore, si dhe nuk ekzistojnë skema sociale për papunësinë. Me qëllim të sigurimit të të ardhurave më të larta se sa ajo që përcaktohet me Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti (75 Euro në muaj), si dhe me qëllim të mos qasjes në kursimet pensionale para moshës 65 vjeçare (200 Euro në muaj), MASHT dhe MPMS, përmes një akti ligjor, mund të trajtojnë këtë problem duke aplikuar njërin nga këto mundësi:

1

Për të gjithë mësimitdhënësit mbi moshën 55 vjeçare dhe me përvojë pune mbi 20 vjet, të cilët përballen me sëmundje dhe komisioni shëndetësor i MPMS vlerëson se nuk mund të vazhdojnë punën, të marrin 50% deri 70% të pagës deri në tejkalimin e sëmundjes apo deri në moshën 65 vjeçare. Sipas të dhënave të MAP, mësimitdhënës mbi moshën 55 vjeçare dhe me mbi 20 vjet përvojë pune janë 5,591 persona (24% e mësimitdhënësve në arsim). Nëse 1% e mësimitdhënësve përballen me sëmundje të rënda kronike, atëherë i bie se rreth 56 mësimitdhënës në vit do të mbulohej nga skema e re e pensioneve të invaliditetit në punë në arsim. Bazuar në projektligjin për paga në sektorin publik, i cili po shqyrtohet në Kuvendin e Kosovës, paga bazë do të jetë 466 Euro. Me 50% deri 70% të pagës bazë e cila do të iu paguhet si pension invalidor mësimitdhënësve, nevojiten mbi 156 mijë deri në mbi 219 mijë Euro në vit për mbulimin e pensioneve invalidore të mësimitdhënësve.

2

Në rast se nuk aplikohet kriteri i përvojës së punës dhe moshës së mësimitdhënësve dhe marrim për bazë se sërish 1% e të gjithë mësimitdhënësve përballen me sëmundje të rënda, buxheti vjetor për pensionet e kësaj kategorie mund të ndryshojë nga mbi 651 mijë Euro (me 50% të pagës bazë në arsim - 466 Euro) deri në 912 mijë Euro (me 70% të pagës bazë - 466 Euro).

3

Në aspektin afatgjatë, duke u bazuar në shembullin e Bullgarisë, me qëllim të mbulimit të pensioneve të parakohshme për shkaqe shëndetësore, institucionet publike mund të themelojnë një fond të detyrueshëm pensional për të gjithë punonjësit e arsimit, të cilët krahas kontributeve pensionale në Trust, ndajnë një përqindje të pagës në fond të veçantë i cili mund të përdoret në rast të sëmundjeve të rënda para moshës 65 vjeçare. Në rast se nuk ka nevojë të shfrytëzohet, ai mund të jetë pastaj pension plotësues së bashku me kursimet e Trust-it. Në këtë mënyrë buxheti i shtetit nuk do të rëndohej për pensionet e parakohshme për shkaqe shëndetësore.

Vazhdimi i gjendjes aktuale, ku mësimdhënësit me gjendje të rënduar shëndetësore vazhdojnë të punojnë por nuk mund të jenë në nivel të detyrës, apo mungojnë më shumë se sa që mundësohet me Ligjin e punës për pushim mjekësor, nuk do të ketë efekt shtesë në skemat sociale të MPMS, por indirekt ka ndikim të madh financiar pasi që ndikon në humbjen e orëve mësimore dhe rënien e cilësisë së arsimit.

Varësisht nga mënyrat që do të zgjedhshin, institucionet publike duhet të ndryshojnë Ligjin aktual për skemat pensionale të financuara nga shteti, Ligjin për fondet pensionale, apo të aprovojnë një ligj të ri.

Përfundim

Përkundër popullsisë më të re në Evropë, për shkak të papunësisë së lartë, Kosova përballet me probleme të shumta sociale dhe ekonomike. Papunësia e lartë ndikon edhe në të hyrat buxhetore të shtetit, rrjedhimisht e bën të vështirë mbulimin e shpenzimeve për skemat sociale. Pagat e ulëta nuk mundësojnë pensione afatgjata as për ata të cilët kontribuojnë në Fondin e Kursimeve Pensionale vazhdimisht që nga viti 2003. Shkalla e lartë e joaktivitetit dhe papunësisë, së bashku me trendin e plakjes së popullsisë dhe emigracionit, do të ndikojnë në rritjen e barrës buxhetore për skemat pensionale dhe rëndimin e gjendjes sociale.

Në këtë drejtim, Kosova nuk guxon të ulë moshën e pensionimit nën moshën 65 vjeçare apo të krijoj skema të përgjithshme të pensionimit të parakohshëm, ashtu siç ka filluar me zyrtarët policor dhe ashtu siç është kërkuar nga SBASHK. Megjithatë, institucionet publike duhet të iniciojnë një akt ligjor që rregullon pensionimin e parakohshëm të të punësuarve në sektorin publik të cilët përballen me sëmundje të rënda shëndetësore dhe nuk janë të aftë të ushtrojnë punën me kapacitet të plotë. Kjo më së shumti ka pasur ndikim në sektorin e arsimit, ku janë raportuar raste kur mësuesit të cilët përballen me sëmundje të rënda kronike, obligohen të mbajnë orët e mësimin ngase mundësitë e tyre janë të kufizuara. Këta persona mund të marrin deri në 20 ditë pushim mjekësor apo pushim me pagesë për tre (3) muaj në vlerë të 70% të pagës nga punëdhënësi sipas Ligjit të punës dhe pastaj të vazhdojnë të paraqiten në punë; të përfitojnë 75 euro nga pensioni invalidor, apo të fillojnë të shfrytëzojnë kursimet pensionale dhe të rrezikojnë të mbeten pa kursime pas moshës 65 vjeçare. Mos zbatimi i Ligjit për sigurimet shëndetësore vetëm se e rëndon situatën e kësaj kategorie.

Prandaj, me qëllim të sigurimit të një pensioni dinjitoz, pa rrezikuar kursimet pensionale të tyre, institucionet publike duhet të aprovojnë një ligj të ri ose të ndryshojnë Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti për të përfshirë pensionin e parakohshëm për shkaqe shëndetësore për punonjësit e arsimit dhe punonjësit tjerë në sektorin publik. Para se të ndërmarrin një hap të tillë për aprovimin e një ligji të ri apo ndryshimin e ligjit aktual për skemat pensionale, MASHT dhe MPMS duhet të ndërmarrin masat si në vijim:

- Përgatitjen e një studimi gjithëpërfshirës për punonjësit publik dhe identifikimin e sektorëve punonjësit e të cilëve është e domosdoshme të përfitojnë nga pensionet e parakohshme për shkaqe shëndetësore. Kësisoj do të shmangej praktika e trajtimit me akte ligjore të veçanta për kategori të ndryshme të të punësuarve;
- Identifikimin e të gjitha rasteve të punonjësve arsimor me sëmundje të rënda kronike. Identifikimi i rasteve, duke përfshirë edhe moshën e tyre dhe përvojën e punës, do të mundësonte llogaritjen buxhetore për pensionet e parakohshme dhe vendosjen e kriteve për marrjen e pensioneve;
- Shuma e pensionit duhet të jetë më e ulët se sa paga me qëllim të parandalimit të mashtrimeve për marrjen e statusit të pensionerit të parakohshëm për arsye shëndetësore;
- Verifikimi i rasteve duhet të bëhet nga një komision profesional mjekësor që funksionon në kuadër të MPMS.

Aneks:

Të dhëna mbi nivelin e përgatitjes shkollore të mësimeve sipas grupmoshave dhe kategorive të mësimeve

Figura 14:
Motrat edukatore sipas moshës (Ilogaritje e bazuar në të dhënat e MAP)




Figura 15:
Mësimdhënësit në nivelin parafillor sipas moshës dhe gjinisë (llogaritje e bazuar në të dhënat e MAP)




Figura 16:
Mësimdhënësit në nivelin fillor sipas moshës dhe gjinisë (llogaritje e bazuar në të dhënat e MAP)




Figura 17:
Mësimdhënësit në nivelin e mesëm sipas moshës dhe gjinisë
(llogaritje e bazuar në të dhënat e MAP)




Figura 18:
Mësimdhënësit me shkollë normale sipas moshës (Ilogaritje e bazuar në të dhënat e MAP)




Figura 19:
Mësimdhënësit me Shkollë të Lartë Pedagogjike sipas moshës (Ilogaritje e bazuar në të dhënat e MAP)




Figura 20:
Mësimdhënësit me Baçelor sipas moshës (Ilogaritje e bazuar në të dhënat e MAP)




Figura 21:
Mësimdhënësit me magjistraturë dhe doktoraturë sipas moshës
(llogaritje e bazuar në të dhënat e MAP)

